



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2895 prot

Laç, me. 18 . 06 . 2024

Lënda : Njoftim për shpallje vende të lira pune "Polic", tek Policia Bashkiake ,Bashkia Kurbin.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT
Adresa: Bulevardi "B. Curri" pranë ish-Hotel "Arbana"
TIRANË

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake" Kreu i III, Ligjin Nr.7961.datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), Vendimin nr.328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të Nëpunësve Civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", në Vendimin nr. 39, datë 19.12.2023 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në varësi për vitin 2024", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.219, datë 28.12.2023 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kurbin, Institucioneve dhe Agjensive në varësi dhe klasat e pagave për nëpunësit civile në Bashki dhe Njësitë Administrative për vitin 2024, "Bashkia Kurbin njofton se në administratën e saj ka 2 (dy) vende të lirë pune, në pozicionin e mëposhtëm:

- "Polic Bashkiak", tek Policia Bashkiake

Njoftimi për sa më sipër, do t'ju niset edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@shkp.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoj:
DREJTORE E BNJ
Jurgena TUCI

KRYETAR
Majlinda CARA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2895/prot

Laç, më. 18.06.2024

NJOFTIM PËR VEND PUNE

**NJOFTIM PËR SHPALLJE VENDE TË LIRA PUNE "POLIC", TEK POLICIA
BASHKIAKE, BASHKIA KURBIN**

Mbështetur në Ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake" Kreu i III, Ligjin Nr.7961.datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" (të ndryshuar), Vendimin nr.328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të Nëpunësve Civilë e të punonjësve administrativë të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", në Vendimin nr. 39, datë 19.12.2023 të Këshillit Bashkiak, "Për miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në varësi për vitin 2024", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.219, datë 28.12.2023 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Kurbin, Institucioneve dhe Agjensive në varësi dhe klasat e pagave për nëpunësit civile në Bashki dhe Njësitë Administrative për vitin 2024, "Bashkia Kurbin njofton se në administratën e saj ka 2 (dy) vende të lirë pune, në pozicionin e mëposhtëm:

• **"Polic Bashkiak", tek Policia Bashkiake**

Kriteret për pranimin në Policinë Bashkiake:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvatjeje penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të mos jetë larguar nga policia e shtetit dhe garda e republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- Të paraqesë vërtëtimin e besueshmërisë

Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion është:

Per Pozicionin "Polic", tek Policia Bashkiake:

- T'i shërbejë komunitetit në çdo kohë për problemet që dalin në dinamikë dhe të veprojë me shpejtësi për zgjidhjen e tyre (dëmtim trotuaresh, asfaltesh, zënie trotuaresh, zënie e paligjshme e trojeve të ndërtesave e objekteve publike të Bashkisë dhe të organizojë lirin e tyre, hedhje inertesh jashtë vendeve të caktuara etj)
- Në bashkëpunim me Rajonet e Bashkisë punon për zgjidhjen e konflikteve midis qytetarëve për ndërtime pa leje, zënie trojesh, ndarjen e ndihmës ekonomike e asistencën sociale.
- Së bashku me Drejtorinë e të Ardhurave në Bashki ushtron kontroll dhe merr masa shtrënguese për liçensimin dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj Bashkisë të subjekteve private për aktivitet që kryejnë.
- Kërkon zbatimin e rregullave në vendet e caktuara për tregëtim nga Bashkia dhe merr masa për të ndihmuar personat përgjegjës në vjeljen e të ardhurave.
- Ushtron kontrole dhe merr masa parandaluese nga dëmtuesit dhe abuzuesit për sipërfaqet e gjelbëruara në qytet.

III- Dorëzimi i dokumenteve : Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokoll-Arkivit :

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit(CV);
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- Fotokopje e diplomës e shkollës së mesme (e noterizuar), ose diplomë e shkollës së Lartë (e noterizuar),
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore ;
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor;
- Aktin e emërimit si nëpunës civil;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të kartës së identitetit.

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet nga kandidati deri në datën 20.06.2024.

IV-Rezultatet për verifikimin paraprak të kushteve minimale të procedurës së vendit të punës do të dalin në datë **20.06.2024**, në faqen zyrtare të Institucionit të dhe në stendën e informimit të publikut.

- Komisioni përzgjedhës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, të përcaktuara edhe në shpalljen për konkurrim.
- Në përfundim të verifikimit, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në faqen zyrtare të bashkisë Kurbin dhe në ambientet e brendshme të saj.
- Kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave.
- Lista administrohet nga njësia e Burimeve Njerëzore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar, njoftohen individualisht nga njësia e Burimeve Njerëzore.

Konkurrimi-Testimi me shkrim dhe testimi i aftësive fizike do të zhvillohet në ambientet e Bashkisë (salla e mbledhjeve) në datën **21.06.2024 ora 10.00**.

- Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse kandidati zotëron njohuritë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë Bashkiake.
- Testimi me shkrim hartohet, administrohet dhe vlerësohet me pikë nga komisioni përzgjedhës.
- Në përfundim të testimit me shkrim, komisioni publikon zyrtarisht listën me rezultatet e testimit në rend zbritës në faqen zyrtare të bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.
- Kandidati që ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin me shkrim njoftohet për të vazhduar konkurrimin.

- **V/I-Në testimin me shkrim kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:**

- Ligjin Nr.89/2022 ‘Për Policinë Bashkiake’
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 ‘Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Kodin e Proedurave Administrative;
- Ligjin nr.139/2015, ‘Për Vetëqeverisjen Vendore’
- Ligjin nr.119/2014 ‘Për Të Drejtën e Informimit’
- Ligjin 9367, date 07.04.2005 ‘Për parandalimin e konfliktit të interesit(të ndryshuar)’;
- Rregulloren e Brendshme të Bashkisë .

- **V/II-Testimi i aftësisë fizike**, kandidatët që kalojnë testimin me shkrim i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, i cili teston aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

- Përmbajtja e testimit të aftësive fizike dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve përgatiten nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.
- Kandidati quhet fitues kur ka marre mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin e aftësive fizike.
- Kandidatët fitues renditen sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm dhe njoftohen për intervistën.

V/III-Intervista me gojë

- Kandidati vlerësohet përmes intervistës lidhur me përshtatshmërinë dhe pranueshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës.
- Komisioni i bën kandidatit pyetje të strukturuar, të cilat testojnë formimin dhe aftësitë e tij.

V-Përfundimi i procesit të konkurrimit

- Procedura e konkurrimit përfundon me intervistën. Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, komisioni liston kandidatët fitues.
- Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista.
- Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve ishte 100 (njqind), të cilat ndahen përkatësisht:
 - a) testimi me shkrim, 60 (gjashtëdhjetë) pikë ;
 - b) testimi i aftësive fizike, 20 (njëzet) pikë;
 - c) intervista, 20 (njëzet) pikë.
- Kandidatët renditen në listën përfundimtare, sipas rezultateve të arritura në rend zbritës, sipas pikëve totale të marra.
- Administrimi i listës së fituesve të nxjerr nga Komisioni Përzgjedhës bëhet nga njësia e burimeve.
- Lista e kandidatëve, që kanë rezultuar të suksesshëm, është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga data e përfundimit të procesit të pranimit.

VI- Ankimi

- Kandidati ka të drejtë të bejë ankim me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese.
- Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë), diteve kalendarike nga:
 - a) data e njoftimit individual të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;
 - b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim;
 - c) data e njoftimit individual të rezultatit të testimit të aftësive fizike;
 - d) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të percaktuara.
- Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë), ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.
- Në përfundim të këtij afati, njësia e Burimeve Njerëzore publikon listën përfundimtare fitues.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën: Bashkia Kurbin email bashkiakurbin@gmail.com

DREJTORE E BNJ

Jurgena TUCI



KRYETAR

Majlinda CARA

